



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 24.6.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Slavko Simiq Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Valdete Bajrami.

Munguan: Kujtim Paçaku.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Albulena Nuha-RTV21; Kaltrina Ahmeti-GLPS; Tringa Bytyçi-GLPS, Ukë Gashi-ZPRK; Arta Xhylani, praktikante në Kuvendin e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr. 16 dhe nr. 17;
3. Shqyrtimi i peticioneve;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr. 16 dhe 17

Mexhide Mjaku- Topalli, kërkoi që në procesverbalin nr. 16, të dt. 22.5.2015, të shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit, amendamenti 4, neni 8, paragrafi 8, ka qenë propozuese e këtij amendamenti dhe kjo të përfshihet në procesverbal.

Teuta Haxhiu, tha se propozimi ishte i deputetes, por ka kaluar në Komision. Pra, si Komision, jemi marrë vesh, përfundimet janë nga Komisioni.

Mexhide Mjaku- Topalli, sqaroi për deputeten Haxhiu, që dëshiron të shkruhet me kërkesë të deputetes dhe përkrahje të Komisionit ka kaluar ai amendament, sepse gjatë të gjitha mbledhjeve ka referuar për këtë ndryshim të këtij amendamenti, se edhe nëse nuk ishte aprovuar, do të kishte ndjekur procedurë tjetër, por me përkrahje është përfshirë dhe kjo duhet cekur.

Salihe Mustafa, tha se kolegja po kërkon vetëm të shkruhet ajo që ka propozuar dhe që Komisioni e ka përkrahur.

Teuta Haxhiu, procesverbali është për ndryshime që dikush ka thënë e nuk është shkruar apo i është ndryshuar, por këtu ka të bëjë me një vendim të Komisionit, nuk mund të kthehen vendimet e Komisionit.

Mexhide Mjaku-Topalli, kërkoi që vetëm fjala e saj të shkruhet, asgjë më shumë.

Kryetarja, tha se do të konsultohet me administratën dhe të shohë në incizimet e realizuara, edhe pse thotë se bëhet fjalë për procesverbale, dhe jo për transkripte, që shënohen të gjitha. Ajo tha se ky procesverbal mbetet të miratohet në mbledhjen e radhës.

Kryetarja konstatoi se procesverbali nr. 17, i mbledhjes së mbajtur më dt. 3 qershor 2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i peticioneve

Lirije Kajtazi, tha se janë plotësuar kushtet për shqyrtimin e ankesës së Bogoljub Staletoviq, zv.avokat i popullit, edhe pse ka ngadalësuar pak në kohë, lidhur me

suspendimin nga pozita e zv.avokatit të popullit dhe zvogëlimin e të ardhurave në 50%. Shpjegoi se z.Staletoviq ka qenë zëvendës i Avokatit të Popullit dhe se Avokati i Popullit, vitin e kaluar, i ka propozuar Kuvendit për shkarkim.

Si Komision për të Drejtat e Njeriut, duhet të fokusohet në shkresën e dytë të avokatit, sepse zbritja e të ardhurave në 50% është e paraparë edhe me ligj, por ajo që t'ia ndalë pagën në përgjithësi, nuk parashihet me ligj, andaj ajo kërkoi nga anëtarët e Komisionit të japin mendimet e tyre, në mënyrë që të nxjerrin përfundimet për këtë çështje.

Mytaher Haskuka, tha se siç është rasti i petitionit të grandit, pastaj peticioni i znj.Podrimçaku, e shumë çështje të rasteve të tilla, e sheh si të arsyeshme angazhimin e ekspertit ligjor, sepse na duhet për këshilla për të gjitha këto raste.

Teuta Haxhiu,tha se nga ajo që ka lexuar, ka vënë re që Avokati i Popullit ka pasur të drejtë për propozimin që i ka bërë Kuvendit dhe si Komision, ta dërgojmë në Kuvend.

Slavko Simiq, nuk pajtohet me deputeten Haxhiu, edhe pse nuk është përfaqësues i tij, ankesa është bërë në vitin e kaluar dhe situata e krijuar ka marrë shumë kohë. Po ashtu, mendon se 15 ditë është përgjigjja në peticion brenda Komisionit, andaj edhe nuk pajtohet, ku para se gjithash, duhet shikuar ligjin, a duhet apo jo shkarkimi, sepse ai nuk ka qenë i ndjekur penalisht e as i dënua me burg. Këtij zotëri Staletoviqit ia ka ndaluar edhe të hyjë në Institucionin e Avokatit të Popullit, duke ia shkurtuar edhe disa benificione, andaj duhet shqyrtuar mundësia që zëvendësit t'i vazhdohet puna, gjithashtu edhe rregullimi i pagesës. Kjo është në interes të komunitetit serb, që ai të kthehet në atë pozitë dhe të vazhdojë mandatin deri në muajin tetor, siç mendon ai.

Teuta Haxhiu, lidhur me këtë çështje, theksoi se secili duhet t'i dijë përgjegjësitë e veta dhe nëse performancat e tyre nuk janë të mira, ndaj tyre duhet të kërkohet propozimi për shkarkim dhe ndaj tyre të veprohet në pajtim me ligjin. Lidhur me propozimin për shkarkim, ajo tha se në bazë të shkresave që ka, Avokati i Popullit nuk ka bërë shkelje, sepse këtë mundësi atij ia lejon ligji. Në fund, ajo tha se të gjithë duhet të mësohen të punojnë, pa marrë parasysh a janë komunitet pakicë apo shumicë dhe të mësohen t'i respektojnë ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe të dinë që janë shtetas të Republikës së Kosovës.

Salihe Mustafa, ishte e pajtimit me mendimin e parafolësës, që mos të ketë privilegje për askënd, pa marrë parasysh se kush është ai, por rregullat të vlejnë për të gjithë, në mënyrë të barabartë. Ajo theksoi se e kanë dokumentacionin e paraqitur edhe nga zëvendës-avokati, por edhe vendimin që e ka paraqitur Avokati i Popullit. Duke u ndërlidhur me këtë, ajo tha se do të kishte qenë mirë që ata t'i kenë në takim dhe t'i dëgjojnë se çka do të deklarojnë në takim dhe pastaj, si Komision, ta përmbushin obligimin që e kanë për ta dërguar çështjen në Kuvend.

Teuta Haxhiu, theksoi se nëse duhet të dëgjohet zëvendësi i Avokatit të Popullit, atëherë duhet të ftohet në takim edhe Avokati i Popullit, në mënyrë që të dëgjojnë të dy palët dhe të kenë informata të drejtpërdrejta nga të dyja palët.

Mexhide Mjaku – Topalli, theksoi se forma më e mirë do të ishte propozimi i kolegut Mytaher Haskuka, i cili propozoi që për këto çështje të angazhohet një ekspert dhe të nxirren mendimet lidhur me petitionet e theksuara.

Kryetarja, lidhur me këtë çështje theksoi se ai ankesën e ka adresuar në Komision, sikur që ka të drejtë ta dërgojë çështjen edhe në gjykatë.

Valdete Bajrami, shfaqti mendimin e saj që si Komision të vërtetojnë se a është propozimi i Avokatit të Popullit në përputhje me të drejtat e njeriut, domethënë a i ka shkelur të drejtat e njeriut apo nuk i ka shkelur.

Teuta Haxhiu, theksoi se përderisa ka vakum ligjor për vendin se ku duhet të drejtohen ankesat, për këto çështje duhet të debatojnë si Komision, dhe pastaj të përcillet për Kuvend dhe të vendosë Kuvendi për këtë çështje. Lidhur me beneficionet, ajo ishte e mendimit që vendimi i Avokatit të Popullit të mbetet në fuqi, derisa të vendosë Kuvendi për këtë.

Kryetarja, theksoi se në pjesën e dytë të vendimit, tek ndalimi i të ardhurave, le të konstatohet se Avokati i Popullit i ka kaluar kompetencat e tij dhe ka bërë shkelje, kurse tek pjesa e propozimit, ai këto i ka të përcaktuara me ligj edhe rrugën sesi duhet të rrjedhë situata. Ajo ishte e mendimit që t'i rekomandohet Kuvendit që ta shqyrtojë propozimin e Avokatit të Popullit, por t'i lejohet zëvendësit të tij, që deri në marrjen e një vendimi nga Kuvendi, t'i lejohen të ardhurat me përqindjen e cekur, në bazë të vendimit të Avokatit të Popullit, sepse nuk është në rregull që t'i mohohet një drejtë që ia garanton ligji të gjithëve, pa dallim.

Teuta Haxhiu, nuk kishte mendim të njëjtë. Ajo u pajtua që t'i rekomandohet Kuvendit që ta shqyrtojë propozimin e Avokatit të Popullit, por të mbetet në fuqi vendimi i Avokatit të Popullit, sa i përket të ardhurave të zëvendësavokatit, derisa të ketë një vendim nga ana e Kuvendit.

Kryetarja, vendimi i parë i Avokatit të Popullit, që i propozohet Kuvendit, është në përputhje me ligjin, ndërsa veprimet e tij që janë kompetencë e Kuvendit, nuk janë korrekte dhe është mirë që rekomandimi të nxirret me këtë vërejtje. Pra, kjo shkon në Kuvend, por avokati ka tejkaluar kompetencën e vet në këtë pikë. Avokati nuk është dashur të ngutet, para se Kuvendi të marrë vendim, por as avokati, e as zëvendësi nuk janë fajtorë që Kuvendi nuk ka funksionuar.

Salihe Mustafa, propozoi që mbledhjen e radhës, të ftohen edhe Avokati i Popullit, edhe zëvendësi i Avokatit të Popullit, në të njëjtën ditë, por në kohë të ndryshme. Pra, t'i dëgjojmë të dy palët dhe pastaj të vendosim.

Teuta Haxhiu, ne si Komision, të kërkojmë me një shkresë nga Avokati i Popullit që të na sjellë argumente shtesë për çështjen që ne po e diskutojmë, pra për vendimin e dytë se në çka është bazuar, dhe pastaj të takohemi për të marrë vendimin, përndryshe nëse shkohet me propozim për Kuvend, unë jam që t'i ndajmë, le të shkojnë dy shkresa.

Kryetarja, tha se me sa po shoh, po pajtoheni me propozimin e deputetes Teuta Haxhiu, që t'i drejtohem avokatit me një shkresë për të na sjellë me shkrim argumente shtesë dhe konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të kërkohet nga Avokati i Popullit të sjellë me shkrim argumentet se në çka është bazuar kur ka marrë vendimin që pas datës 8 tetor, kur zëvendësit i ka skaduar mandati, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka kurrfarë detyrimi ligjor nga marrëdhënia e punës për z.Staletoviq.

Në mbledhjen e radhës, të ftohen në kohë të ndryshme, Avokati i Popullit dhe zëvendësi i Avokatit të Popullit, që t'i dëgjojmë të dy palët lidhur me këtë ankesë.

Kryetarja, tha se për shqyrtim e kemi edhe ankesën e Zahrije Podrimçakut. Në mbledhjen e kaluar nuk e shqyrtuam, sepse udhëheqësja e grupit punues për shqyrtimin e kësaj ankese, deputetja Valdete Bajrami, nuk ishte prezent.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, nuk është kompetent për shqyrtimin e ankesave të kësaj natyre në këtë fazë, pasi që Zahrie Podrimçaku, nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet në rrugë administrative për zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Udhëzohet znj. Zahrie Podrimçaku, konform Ligjit nr. 03/ L – 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, t'i drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, i cili është kompetent për lëndët në fushën e shërbimit civil në Kosovë.

5. Të ndryshme

Kryetarja, tha se grupi punues ka punuar në monitorimin e Ligjit për personat e verbër dhe se e kanë përgatitur draft-raportin, dhe në emër të grupit, të njoftojë kryesuesja e grupit punues.

Salihe Mustafa, tha se është mirë që grupi punues të takohet edhe një herë dhe të diskutojë dhe pastaj ta sjellin raportin në Komision, i cili edhe në Komision mund të pësojë ndryshime. Pra, të miratohet dhe pastaj të procedohet për në Kuvend.

Mytaher Haskuka, tha se për monitorimin e Ligjit për personat e verbër ka pasur disa takime individuale me disa organizata dhe kur të bëhet raporti, është mirë të diskutohet për disa nga çështjet që i kanë ngritur ata dhe të përfshihen në raport.

Salihe Mustafa, tha se vizitat për monitorimin e këtij ligji kanë përfunduar dhe është duke u punuar raporti, pastaj vjen në Komision dhe mund të plotësohet dhe të diskutohet sikur për të gjitha çështjet e tjera.

Kryetarja,tha se edhe njëherë po ua rikujtoj që më dt. 29 dhe 30 qershor, mbahet punëtorja dyditore për shqyrtimin e udhëzuesit për peticione.

Në këtë punëtori, prezencën e vet e kanë konfirmuar 5 anëtarë të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi